



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2021:251927

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05384383

P.nr. 559/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me procesmbajtësen Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit H. A., për shkak të veprës penale “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”, të parashikuar nga neni 401 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.5180/2021, të datës 12.11.2021, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik, të mbajtur me datë 29.01.2024, në të cilin ish-in të pranishëm prokurori i shtetit Menduhi Kastrati, të dëmtuarit G. Sh., D. S. dhe A. D. - zyrtar policor, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. H. M., me datë 30.01.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 28.02.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

H. A., nga i ati K. dhe nëna Sh., mbiemri i vajzërisë së nënës A., i lindur më ... në P., me vendbanim në fshatin D., Komuna P., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor fizik, i martuar, baba i katër (4) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I. I pandehuri H. A., me datë 08.10.2021, në ora 21:48, në rrugën “...” në P., derisa zyrtarët policor G. Sh., D. S. dhe A. D., gjatë detyrës së tyre zyrtare kishin dashur qe ta shoqëronin në stacion personin R. A. me qëllim të legjitimit pas qe ai nuk kishte dokumentacion, atëherë kishte ndërhyrë i pandehuri i cili e kishte përdorur forcën fizike në atë mënyrë qe i kishte shtyrë

zyrtarët policor duke thënë se nuk mund ta arrestoni personin në fjalë dhe e kishte kapur për dore nga mbrapa shpinës zyrtarin policor G. Sh..

- me këtë ka kryer veprën penale “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”, të parashikuar nga neni 401 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, si dhe neneve 364, 367 dhe 449 par. 2 nënpar. 2.6 të KPP-së, të pandehurin e:

GJYKON ME KUSHT

I. Ashtu që i cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën e verifikimit prej dy (2) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale.

II. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - për paushallin gjyqësor të paguajë shumën prej dyqind (200) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimin shumën prej njëzet (20) Euro, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Të dëmtuarit G. Sh., D. S. dhe A. D. që të tre zyrtar policor, nuk kanë parashtruar kërkesë pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.5180/2021, të datës 12.11.2021, kundër të pandehurit H. A., për shkak të veprës penale “Pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare”, të parashikuar nga neni 401. Par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata në kuptim të nenit 280 të KPP-së, ka caktuar kohën për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, ashtu që pas hapjes së seancës, shpalljes së çështjes për gjykim dhe leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, të njëjtit në kuptim të nenit 321 par. 1 të KPP-së, i ofroi mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në fillim të shqyrtimit gjyqësor është deklaruar i pafajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar, andaj në kuptim të nenit 323 të KPP-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me radhën e paraqitjes së provave: fjalën hyrëse të palëve, prezantimin e provave, dëgjimin e të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve, mbrojtjen e të pandehurit, si dhe me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar, duke shtuar se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, mjaftueshëm është vërtetuar gjendja faktike se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ngase i njëjti siç edhe është vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarve - dëshmitarëve G. Sh., D. S. dhe A. D. sikurse edhe nga provat tjera shkresore, ditën kritike të datës 08.10.2021, në rrugën “...” në P., derisa zyrtarët policor tani të dëmtuarit kanë qenë në kryerje të detyrës zyrtare dhe derisa

kanë dashur ta shoqërojnë në stacion policor personin R. A. me qëllim legjitimimi pasi që ky i fundit nuk kishte pasur dokument identifikimi, i pandehuri ka përdorur forcën ashtu që nga mbrapa shpinës kishte kapur për dore zyrtarin policor G. Sh., ku në këtë mënyrë zyrtarëve policor u pamundësohet që në mënyrë efektive të kryejnë detyrat e tyre zyrtare, veprime këto të cilat përbëjnë elemente të veprës penale “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”, andaj nga gjykata kërkoi që i pandehuri të shpallet fajtor dhe dënohet sipas ligjit.

Të dëmtuarit G. Sh., D. S. dhe A. D., në fjalën e tyre përfundimtare kanë deklaruar se qëndrojnë pranë raporteve policore të përpiluara nga ana e tyre lidhur me rastin, për të pandehurin nga gjykata kërkuan që të nxjerrë vendim meritore, ndërsa nuk kanë parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit H. A., av. H. M., në fjalën përfundimtare ka paraqitur kundërshtimet e tij lidhur me pretendimet e prokurorisë të parashtruara në aktakuzë, duke theksuar se në veprimet e të mbrojturit të tij nuk janë konsumuar elementet që përbëjnë figurën e veprës penale e cila i vihet në barrë ngase analizuar identitetin objektiv dhe subjektiv të aktakuzës, në asnjërin nga deklaratat e zyrtarëve policor e as në raportet parapenale nuk është thënë se zyrtari policor G. Sh. ka pasur për qëllim për ta arrestuar apo prangosur qytetarin R. A. e as që është tentuar, përkundër kësaj, qasja e zyrtarit policor G. Sh. në raport me këtë person ka qenë në korniza të rregullores dhe autorizimeve të tij si zyrtar policor, për ta legjitimuar, mirëpo në mungesë të dokumentit për legjitimim i është thënë se duhet shoqëruar në stacion policor për të vërtetuar identitetin e tij. Ajo çfarë është më rëndësi për tu potencuar qëndron fakti se R. A. në raport me të mbrojturin e tij janë në farestisni apo raport familjar, gjegjësisht nipi i të mbrojturit të tij dhe mund të ketë qenë subjektiv dhe jo korrekt gjatë bisedës me zyrtarin policor G. Sh. mirëpo assesit të ketë pasur kontakt fizik e as ta ketë penguar në ndonjë formë tjetër në kryerjen e detyrave zyrtare andaj, bazuar në të lartcekurat propozoi që gjykata të nxjerrë aktgjykim lirues pasi që nuk ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të mbrojturit të tij manifestohen elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, nëse gjykata të njëjtin e gjen fajtor, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit t’i shqiptojë një dënim të kushtëzuar apo në situatën më të pafavorshme nëse të njëjtit i cakton dënim me burgim, atëherë në kuptim të nenit 44 të KPRK-së këtë dënim t’ia zëvendësojë me dënim me gjobë, të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, gjendjen e dobët ekonomike të tij, është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, është person familjar.

I pandehuri H. A. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, kërkoi falje për veprimet e tij në raport me zyrtarët policor, ngjarja ka qenë e momentit, ndërsa sa i përket vendimit mbi dënimin, nga gjykata kërkoi që t’i shqiptojë një dënim sa më të butë.

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 7 dhe nenit 360 të KPP-së, ka bërë administrimin e provave të propozuara nga palët, janë lexuar: Raporti i oficerit G. Sh. i datës 08.10.2021, Informacionet e personit mbi të kaluarën kriminale, deklaratat e të dëmtuarës A. D. dhënë në polici e datës 09.11.2021, deklaratat e të pandehurit dhënë në polici e datës 08.10.2021, në cilësi të dëshmitarëve janë dëgjuar të dëmtuarit zyrtar policor G. Sh., A. D. dhe D. S., si dhe i pandehuri ka paraqitur mbrojtjen e tij.

I dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, zyrtari policor G. Sh., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.09.2023 ka deklaruar se ditën kritike derisa ishin në krye të detyrës së bashku me kolegët e tij zyrtarët policor D. S. dhe A. D., i janë përgjigjur thirrjes për të shkuar në vendin e ngjarjes, në rrugën “...” në P. ku kishte ndodhur një aksident trafiku, ku nga palët e përfshira në aksident

kishte kërkuar dokumentet e identifikimit mirëpo njëri nga ata R. A. kishe refuzuar që t'i bindet urdhrin, arsye kjo për të cilën kishte kërkuar nga ky i fundit që ta shoqërojnë në stacion policor me qëllim të vërtetimit të identitetit të tij dhe derisa e ka shtyrë të njëjtin në drejtim të kolegut të tij D. S. për ta marr dhe dërguar në stacion policor, në atë moment ka ndërhyrë i pandehuri i cili zyrtarëve policor u ka thënë se nuk mund ta merrni R., ndërsa (dëshmitarin në fjalë) e ka kapur në dorën e djathtë, e ka shtyrë dhe e ka larguar nga R., ndërsa këtë të fundit e ka shtyrë në drejtim të një grupi njerëzish që kanë qenë në vendin e ngjarjes, ashtu që si rezultat i veprimeve të pandehurit, është vlerësuar si e nevojshme asistencë nga njësitet tjera të cilët sipas kërkesës së tyre kanë arritur në vendin e ngjarjes dhe pa ndonjë rezistencë kanë shoqëruar për në stacion policor të pandehurin H. A. dhe nipin e tij R. A..

E dëmtuara - dëshmitarja A. D. - zyrtare policore, në deklaratën e dhënë gjatë marrjes në pyetje në polici me datë 09.11.2021, ka deklaruar se me datë 08.10.2021, ka qenë në detyrë në ndërrimin e pas ditës së bashku me kolegun e saj tani të dëmtuarin D. S.. Rreth orës 21:48, kanë pranuar një informatë nga mbikëqyrësi i ndërrimit toger G. Sh., lidhur me një aksident trafiku me dëme materiale në rrugën "...", ku me të arritur në vendin e ngjarjes, palët e përfshira në aksident në prezencë të tyre janë deklaruar se kanë arritur marrëveshje. Njëra nga palët e përfshira në aksident R. A., edhe përkundër kërkesës së togerit G. Sh. që të ofrojë dokumentet e identifikimit dhe të automjetit, i njëjti nuk i është bindur urdhrin, ashtu që zyrtari policor në fjalë ka urdhëruar që i njëjti të shoqërohet në stacion policor për të verifikuar identitetin e tij, mirëpo aty në vendin e ngjarjes ndërhyrë një person tani i pandehuri i cili ka penguar togerin G. Sh., duke e kapur për dore nga mbrapa shpinës dhe duke mos e lejuar prangosjen e nipit të tij R. A., arsye kjo për të cilën kanë kërkuar asistencë nga njësitë tjera në terren, të cilët kanë shkuar në vendin e ngjarjes dhe kanë bërë shoqërimin e palëve për në stacion policor.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.12.2023, dëshmitarja në fjalë ka deklaruar se në vendin e ngjarjes ku një aksident trafiku kishte ndodhur, derisa ka qëndruar tek pala e dëmtuar ndërsa kolegu i saj D. S. ka qenë në afërsi të togerit G. Sh., në momentin kur e ka vërejtur të pandehurin duke e kapur për dore togerin G., ka shkuar në drejtim të tyre për t'i asistuar, ngase veprimi i të pandehurit ka qenë i vrazhdë.

I dëmtuari - dëshmitari D. S., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 19.12.2023, ka deklaruar ditën kur ngjarja ka ndodhur, pas pranimin të informatës se një aksident trafiku kishte ndodhur, menjëherë kanë reaguuar dhe me të arritur në vendin e ngjarjes kanë kuptuar se palët e përfshira në aksident kishin arritur marrëveshje mes vete dhe këtë ua kanë komunikuar zyrtarëve policor në vendin e ngjarjes, ku pronari i njërit nga automjetet e përfshira në aksident ka qenë R. A., i cili posa i është kërkuar dokumenti i identifikimit si dhe dokumentacioni i automjetit nga kolegu G. Sh., i njëjti ka refuzuar t'i përgjigjet apo të ofrojë në shikim dokumentin e identifikimit, andaj si rezultat i mos bindjes së tij, derisa kolegu në fjalë ka dashur ta arrestoj, i pandehuri ka ndërhyrë, e ka kapur për dore nga mbrapa togerin G. Sh., saktësisht në shpatullën e krahut, ndërsa nipin e tij R. e ka shtyrë në drejtim të personave të grumbulluar në vendin e ngjarjes, në atë moment sipas dëshmitarit në fjalë, është larguar një hap mbrapa dhe përmes radiolidhjes ka kërkuar asistencë nga njësitë tjera policore, për arsye se ka qenë i pamundur arrestimi i R. A. në turmën e njerëzve derisa ishin vetëm tre zyrtar policor, në vendin e ngjarjes kanë arritur në asistencë njësitë tjera, me ç 'rast i pandehuri dhe nipi i tij R. A. janë shoqëruar për në stacion policor.

Pas marrjes në pyetje të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve dhe prezantimit të provave materiale, në kuptim të nenit 343 par. 1 të KPP-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e tij ka mohuar të ketë pasur kontakt fizik me ndonjërin nga zyrtarët policor apo ndonjë veprim konkret inkriminues në drejtim të veprës penale për të cilën është akuzuar, duke u mbrojtur me faktin se ditën kur ngjarja ka ndodhur, derisa ka qenë duke

shkuar në “...” për të marr djalën e tij A. A., rrugës së vjetër ka parë se kishte ndodhur një aksident trafiku dhe njëra nga automjetet e përfshira në aksident ka qenë e nipit të tij R. A. për çka edhe është ndalur për të pyetur nipin e tij se a është lënduar dhe posa është afruar ka vërejtur zyrtarin policor G. Sh., i cili ka dalë pas shpinës së R. dhe e ka goditur këtë të fundit me dorë (shuplakë) në pjesën e pasme të kokës, veprim ky i cili ka bërë që i pandehuri të reagojë, ashtu që ka larguar nipin e tij R., pas këtij veprimi zyrtari policor G. Sh. dhe kolegët e tij nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim derisa në vendin e ngjarjes kanë arritur njësitë tjera policore në asistencë dhe së bashku me R. janë shoqëruar në stacion policor mirëpo nuk i kanë prangosur e as kontrolluar. I pandehuri po ashtu ka mohuar faktin që zyrtari policor G. Sh. nga drejtuesit e automjeteve të përfshira në aksident këtë kërkuar dokumentet për t’i legjitimuar, e as të ketë kërkuar për ta shoqëruar në stacion policor R. A..

Në procesverbalin e marrjes në pyetje në polici të datës 08.10.2021, i pandehuri ka deklaruar se derisa ka qenë duke kaluar në rrugën “...” kishte vërejtur se kishte ndodhur një aksident trafiku dhe meqenëse në këtë aksident kishte qenë i përfshirë edhe nipi i tij R. A. me automjetin B..., është ndalur për të parë se çfarë kishte ndodhur dhe derisa disa zyrtar policor kishin qenë duke biseduar me nipin e tij dhe personin tjetër i cili ishte i aksidentuar, njëri nga zyrtarët policor ka dashur të arrestojë nipin e tij R., ashtu që i pandehuri kishte ndërhyrë duke i thënë zyrtarit policor se ti nuk ke arsye ta arrestosh dhe nuk mund ta arrestosh, ashtu që kishte hyrë në mes dhe larguar R., pas pak në vendin e ngjarjes kanë arritur edhe zyrtar tjerë policor të cilët e kishin shoqëruar në stacion policor për tu intervistuar.

Rrjedhimisht gjykata, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, vlerësimit me ndërgjegje të secilës provë një nga një dhe në lidhje reciproke me njëra tjetrën, konform nenit 360 par.1 dhe 2 të KPP-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” nga neni 401 par. 5 lidhur me par.1 të KPRK-së, veprë kjo e paraparë në Kapitullin e veprave kundër Rendit Publik, ku në paragrafin 1 të të njëjtit nen është përcaktuar se: *“Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet”*

Forma e cilësuar e kësaj vepre është paraparë me paragrafin 5 të të njëjtit nen, në të cilin është përcaktuar se: *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj gjyqtarit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë apo personit të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria, zyrtarit policor, zyrtarit doganor, zyrtarit ushtarak apo zyrtarit të shërbimit korrektues gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet”.*

Nuk ishte kontestues fakti nga i pandehuri se në mbrëmjen e datës 08.10.2021, në rrugën “...” në P., në vendin e ngjarjes ku kishte ndodhur një aksident trafiku, ishte ndalur pasi kishte vërejtur se njëra nga automjetet e aksidentuara ishte e nipit të tij R. A. sikurse nuk ishte kontestuese se derisa i njëjti është afruar tek nipi i tij për të parë se në çfarë gjendje është, e kishte shtyrë nipin e tij me qëllim që ta largojë nga zyrtari policor G. Sh..

Kontestues nga i pandehuri ishte fakti se në mbrojtjen e tij ka mohuar të ketë ndërmarrë ndonjë veprim konkret inkriminues në drejtim të veprës penale për të cilën është akuzuar, duke u mbrojtur me faktin se me asnjërin nga zyrtarët policor nuk kishte pasur kontakt fizik, përkundër kësaj e kishte lutur zyrtarin policor G. Sh. që mos ta lëndojë nipin e tij R., ndërsa ka mohuar që

zyrtari policor në fjalë të ketë kërkuar nga palët e përfshira në aksident dokumentet për t'i legjitimuar e as të ketë kërkuar nga R. shoqërimin e tij në stacion policor.

Nga deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit G. Sh. zyrtar policor me gradë toger në Stacionin Policor në P., është vërtetuar fakti se ditën kritike, respektivisht me datë 08.10.2021, derisa ishte në krye të detyrës me kolegët e tij tani të dëmtuarit D. S. dhe A. D., i pandehuri H. A. i ka penguar të njëjtit në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare, në atë mënyrë që derisa zyrtari policor G. Sh. ka bërë përpjekje për ta shoqëruar në stacion policor R. A., pronarin e njërit nga automjetet e përfshira në një aksident trafiku për shkak se ky i fundit nuk i është bindur urdhrin zyrtar duke refuzuar prezantimin e dokumentit të identifikimit kur i është kërkuar, i pandehuri me veprimet proaktive fillimisht u drejtohet zyrtarëve policor me fjalët se nuk mund ta merrni R. (nipin e tij), më pas kap për dorën e djathtë zyrtarin policor G. Sh., e shtynë dhe e largon nga R., ndërsa këtë të fundit e shtynë në drejtim të kundërt, veprime këto që kanë pamundësuar kryerjen efektive të detyrës zyrtare, derisa kanë arritur në mbështetje njësitë tjera policore.

Nga deklaratat e të dëmtuarës - dëshmitares A. D. është vërtetuar fakti se në mbrëmjen e ditës kritike, në rrugën "...” derisa kolegu i saj G. Sh. ka bërë përpjekje për ta shoqëruar në stacion policor R. A., pronarin e njërit nga automjetet e përfshira në një aksident trafiku për shkak se ky i fundit nuk i është bindur urdhrin të tij për ti dhënë dokumentin e identifikimit, i pandehuri H. A. e pengon kolegun e saj duke e kapur për dore nga mbrapa shpinës dhe duke mos e lejuar prangosjen e tij, derisa në vendin e ngjarjes kanë arritur për t'i asistuar njësitë tjera në terren, të cilët kanë bërë shoqërimin e të pandehurit H. A. dhe nipit të tij R. A. në stacion policor.

Nga deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit D. S., po ashtu është vërtetuar fakti se në mbrëmjen e ditës kritike, derisa kolegu i tij G. Sh. ka dashur ta shoqërojë në stacion policor R. A. për shkak se ky i fundit nuk i është bindur urdhrin të tij për t'i dhënë dokumentet e identifikimit dhe të automjetit, i pandehuri H. A. ka ndërhyrë dhe e ka kapur për dore nga mbrapa dhe meqenëse ka qenë i pamundur arrestimi i R. A. për shkak të turmës së njerëzve që kanë qenë të pranishëm në vendin e ngjarjes, ka kërkuar asistencë nga njësitë tjera, të cilët kanë bërë shoqërimin e të pandehurit dhe nipit të tij R. në stacion policor.

Deklaratat e të dëmtuarve - dëshmitarëve G. Sh., A. D. dhe D. S. gjykata i çmoi si objektive, reale dhe të sinqerta të cilave ua fali besimin ngase të njëjtat korrespondojnë njëra me tjetrën, me provat tjera të administruara në shqyrtim gjyqësor, gjendjen faktike të vërtetuar, si dhe rrjedhën logjike të ngjarjes.

Në cilësi të provës materiale të propozuar nga prokurori i shtetit për të pandehurin H. A., gjykata ka administruar dhe lexuar si provë Informacionet e personit mbi të kaluarën kriminale lëshuar nga Policia e Kosovës, provë kjo e cila nuk ofron të dhëna të cilat do të mund të merreshin si rrethana rënduese me rastin e caktimit të llojit të sanksionit penal apo lartësisë së dënimit, ndërsa nga të dhënat e siguruara nga sistemi i evidencës penale rezulton se i pandehuri nuk ka qenë i gjykuar apo dënuar më parë me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Gjykata me kujdes të posaçëm ka analizuar dhe vlerësuar mbrojtjen e të pandehurit i cili në shqyrtim gjyqësor ka mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar, duke u mbrojtur me faktin se nipin e tij R. e kishte shtyrë në momentin kur zyrtari policor G. Sh. e kishte goditur këtë të fundit me dorë në pjesën e pasme të kokës, ndërsa ka mohuar të ketë pasur kontakt fizik me ndonjërin nga zyrtarët policor, mbrojtjen e të cilit gjykata e çmoi si të pabazuar për arsye se i njëjti me paraqitjen e fakteve të sajuara se kinse zyrtari policor në fjalë e ka goditur me dorë në pjesën e pasme të kokës nipin e tij R., fakt të cilin nuk e kishte përmendur gjatë marrjes së tij në pyetje në polici, përpiket t'i arsyetojë apo relativizojë veprimet e tij me qëllim të shmangies nga

përgjegjësia penale, ndërsa gjatë marrjes së tij në pyetje në polici kishte pohuar faktin të ketë ndërhyrë dhe t'i ketë thënë zyrtarit policor se “ti nuk ke arsye ta arrestosh dhe nuk mund ta arrestosh” nipin e tij R.”, kundërthënie këto të cilat mbrojtjen e bëjnë të paqëndrueshme për arsye se e njëjta bie në kundërshtim me deklaratat e të dëmtuarve dhënë në shqyrtim gjyqësor, gjendjen faktike të vërtetuar si dhe rrjedhën logjike të ngjarjes, përkundër mos pranimit të fajësisë, i njëjti nuk ka ofruar ndonjë provë konkrete, relevante dhe të besueshme për të vërtetuar të kundërtën e faktit të provuar.

Gjykata po ashtu ka analizuar dhe vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të pandehurit av. H. M., e cila konsiston në atë se në veprimet e të mbrojturit të tij nuk manifestohen elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar, edhe pse mund të ketë qenë subjektiv dhe jo korrekt gjatë bisedës me zyrtarin policor G. Sh., i njëjti nuk ka pasur kontakt fizik e as të ketë penguar në ndonjë formë tjetër zyrtarët policor në kryerjen e detyrave zyrtare, pretendime të cilat gjykata i çmoi si të pabazuara për arsye se nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, deklaratat e të dëmtuarve të cilave secilës veç e veç dhe në tërësinë e tyre gjykata ua fali besimin, mjaftueshëm është argumentuar fakti se ditën kritike i pandehuri me veprimet e tij aktive të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, ka penguar dhe u ka pamundësuar zyrtarëve policor tani të dëmtuarve kryerjen efektive të detyrave zyrtare, për ç ‘arsye këtyre të fundit me qëllim të vënies të situatës nën kontroll u është nevojitur mbështetja e njësiteve tjera policore.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave të rëndësishme, bazuar në faktet dhe provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, deklaratat e të dëmtuarve - dëshmitarëve G. Sh., A. D. dhe D. S., vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm dhe gjeti se në veprimet e të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, në kohë, vend dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, manifestohen elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” nga neni 401 par. 5 lidhur me par.1 të KPRK-së andaj, pasi më parë gjeti se në aspektin penal juridik është përgjegjës dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale të tij, të njëjtun e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh faktin se i njëjti nuk ka qenë i gjykuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, sjelljen korrekte të tij në gjykatë, është mbajtës i familjes, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti andaj, mbi bazën e arsyeve dhe rrethanave të sipër theksuara vlerësoi se dënimi me kusht si dënim alternativ i shqiptuar të pandehurit, është adekuat dhe në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 të KPRK-së, i cili konsiston në risocializimin e të pandehurit me anë të pezullimit të dënimit, me të cilin dënim të pandehurit seriozisht i tërhiqet vërejtja dhe i bëhet me dije se nëse i njëjti kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Vendimi mbi mundësinë e revokimit të dënimit me kusht është marrë në bazë të nenit 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr. 559/2021, dt. 28.02.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimt të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.